

VENDIM
Nr. 494, datë, 30.7.2021

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, TE MINISTRIA E KULTURËS, TË PASURIVE NR. 1/507, LLOJI “SHESH”, NR. 1/102, LLOJI “TRUALL”, NR. 1/260, LLOJI “TRUALL”, ZONA KADASTRALE 8150, TIRANË, DHE PËR KALIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA SHËRBIMI INFORMATIV I SHTETIT TE MINISTRIA E KULTURËS, TË PASURISË NR. 1/509, LLOJI “TRUALL”, ZONA KADASTRALE 8150, TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10, 13 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi te Ministria e Kulturës të pasurisë së paluajtshme shtetërore “Galeria e Arteve”, lloji “truall”, me sipërfaqe totale 3717 (tre mijë e shtatëqind e shtatëmbëdhjetë) m², nga të cilat 1 901 (një mijë e nëntëqind e një) m² ndërtesë, me numër pasurie 1/102, zona kadastrale 8150, Tiranë, sipas planrilevimit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Shërbimi Informativ Shtetëror te Ministria e Kulturës, të pasurisë së paluajtshme shtetërore, lloji “truall”, me sipërfaqe totale 422 (katërqind e njëzet e dy) m², nga të cilat 89 (tetëdhjetë e nëntë) m² ndërtesë, me numër pasurie 1/509, zona kadastrale 8150, Tiranë, sipas planrilevimit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Kalimin në përgjegjësi administrimi, te Ministria e Kulturës të pasurisë së paluajtshme shtetërore, lloji “truall”, me sipërfaqe totale 99 (nëntëdhjetë e nëntë) m², nga të cilat 99 (nëntëdhjetë e nëntë) m² ndërtesë, me numër pasurie 1/260, zona kadastrale 8150, sipas planrilevimit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Kalimin në përgjegjësi administrimi te Ministria e Kulturës të pasurisë së paluajtshme shtetërore, lloji “shesh”, me sipërfaqe totale 5 194 (pesë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e katër) m², me numër pasurie 1/507, zona kadastrale 8150, Tiranë, sipas planrilevimit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Prona e përcaktuar në pikën 2, të këtij vendimi, hiqet nga lista e pronave të paluajtshme shtetërore që i bashkëlidhet vendimit nr. 502, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, me karakter sekret, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Shërbimit Informativ Shtetëror”, të ndryshuar.

6. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Shërbimi Informativ i Shtetit dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

PRONARI: SHTET

DATE 14/07/2021

QELLIMI :REGJISTRIM PASURIE

VENDNDODHJA

BASHKIA_TIRANË

DVASHK:TIRANË VERI

ZONA KADASTRALE:8150

NUMRI PASURISE: Sipas legjendes

INDEX HARTE:TR-P-11,12; TR-Q-11,12

TE DHENAT E PASURISE

LLOJI PASURISE: Sipas legjendes


SIP.PASURISE=Sipas legjendes m 2

SIPERFAQE GJURMES NDERTIMIT=Sipas legjendes m2

NUMRI KATEVE

NUMRI PEMEVE

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE



Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT
1	V ERI			1/72		KUFITARET JANE PERCAKTUAR SIPAS HARTES TREGUESE TE ASHK
2	LINDJE			1/91		KUFITARET JANE PERCAKTUAR SIPAS HARTES TREGUESE TE ASHK
3	JUG			1/395, 1/110,		KUFITARET JANE PERCAKTUAR SIPAS HARTES TREGUESE TE ASHK
4	PERENDIM			1/103		KUFITARET JANE PERCAKTUAR SIPAS HARTES TREGUESE TE ASHK

REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT

EMRI: LORED SHPK
 LICENSA NR :6901/2 DT: 10.05.2021
 NIPT: L86910701U

NENSHKRIMI/VULA

TEKNOLOGJIA E MATJEVE:

Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash;

PERCAKTIMI KUFIRIT:_SIPAS HARTES TREGUESE ASHK DHE MATJEVE FAKTIKE TE KRYERA NE TERREN

SHENIME TE VECANTA:

PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET

EMRI _____
 NENSHKRIMI _____

Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash;
 P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale